



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 89-të, të mbajtur më 20.07.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Veprimi sipas denoncimit të regjistruar sipas numrit 12-342/1 të datës 17.01.2023, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Denoncimi në fjalë të dorëzohet për veprim kompetent në ministrin e punëve të brendshme.

Lënda me numër 12-342/1 të datës 17.01.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më 17 janar 2023, një parashtrues i panjohur ka bërë denoncim me pretendime kundër drejtorit të shkollës së mesme " \_\_\_\_\_ " nga \_\_\_\_\_, pas së cilës është formuar lënda me numër 12-342/1 datë 17.01.2023. Pretendimet i referohen keqpërdorimit të detyrave dhe kompetencave zyrtare në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës nga ana e drejtorit në shkollën në fjalë për shkak të parregullsive në realizimin e prokurimeve publike të cilat nga ana tjetër shkaktojnë implikime financiare në operacionet financiare në dëm të shkollës duke filluar nga viti 2018 e ne vazhdim.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK konstatoi se për pretendimet konkrete, autoritetet tjera kanë kompetenca më të mëdha për të përcaktuar gjendjen faktike, prandaj ka vendosur që raportin t'ia dorëzojë Ministrisë së Punëve të Brendshme për veprime kompetente.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: P.B

Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

Крыетар,  
Biljana Ivanovska

